

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	NATO dhe BE paralajmërojnë Rusinë, Von der Leyen e Rutte pas incidentit në Gjermani: Nuk do toleroj më sjelljen e Moskës – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/nato-dhe-be-paralajmrojne-rusine-von-der-leyen-e-rutte-pas-incidentit-ne-gjermani-nuk-do-tolerojme-sjelljen-e-moskes/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 17:49:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	2 shtator 2026, 13:58:18 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7ae1669b3c616a1975f6c480cb5162cc39e5201b137420e4d330b34278e1d464
TEKSTI	663c074cab968ebf1a1c56ec89d57acd3cbd4c96b916f9929aa99fcd4c322802
PAMJA	60d331578b8c0cae2f62a64dcb0869313a7efaeafb9b5cd6a9cc727b40de4d75

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1fe9973f58d6284e9986fbf8300ef9701a55574d302ece2dd857ffd40b686175
E MËPARSHMJA	6ee146d55b2b6570699369b19bbd0954077c4bb38b3c868fe41dbcdba228e37c
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1fe9973f58d6284e9986fbf8300ef9701a55574d302ece2dd857ffd40b686175>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Incidenti në aeroportin e Leipzig që Gjermania ia ka atribuar Ruisë, ka sjellë një reagim të fortë të Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Një ditë pas akuzave të Berlinit ndaj Moskës, Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, dhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, u takuan në Bruksel për të diskutuar kërcënimet hibride dhe mbështetjen për Ukrainën. Von der Leyen e cilësoi incidentin si një përshkallëzim serioz, duke akuzuar rusinë për një përpjekje që, sipas saj, mund të kishte shkaktuar dëme të mëdha dhe viktima. Ajo paralajmëroi se Evropa nuk do të tërhiqet përballë presionit të Moskës.

“Ky ishte një sulm duke përdorur materiale të nivelit ushtarak, i kryer nga operativë rusë në tokën e BE-së. Dhe ne nuk do ta tolerojmë atë. Nëse qëllimi ishte të na bënte të mendoheshim dy herë për të mbështetur Ukrainën, mund t’ju them se kjo vetëm sa e ka forcuar vendosmërinë time. Frikësimi nuk do të funksionojë”, tha Ursula von der Leyen, presidente e Komisionit Evropian

Brukseli paralajmëron ndërkohë masa të reja ndaj Ruisë, ndërsa ministrat e Jashtëm të vendeve anëtare po diskutojnë sanksione shtesë. Në fokus është edhe forcimi i mbrojtjes së infrastrukturës kritike evropiane, pas një serie incidentesh që autoritetet i konsiderojnë pjesë të luftës hibride. Në të njëjtën linjë është edhe NATO. Mark Rutte shprehu solidaritet të plotë me Gjermaninë dhe theksoi se përpjekjet e Ruisë për të frikësuar aleatët apo për të dobësuar mbështetjen për Ukrainën nuk do të kenë sukses.

“Kemi parë më shumë dronë dhe raketa që kalojnë në hapësirën

5 “Dhembja e pjekurisë mund të shkaktojë tumor”, kirurgu oral: Kur...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

tonë ajrore përgjatë krahut tonë lindor duke krijuar rrezik në rritje dhe gjithashtu kemi parë një rritje të aktiviteteve dashakeqe që synojnë drejtpërdrejt territorin tonë. Qoftë zjarret e vëna në fabrika që zvogëlojnë pajisjet mbrojtëse për Ukrainën apo sulmi hibrid rus në Leipzig, po, ne qëndrojmë në solidaritet të plotë me Gjermaninë, të gjithë aleancën dhe Bashkimin Evropian. Rreziqet që paraqet Rusia janë të qarta dhe ne po punojmë pa ndërprerje për të siguruar që jemi të përgatitur për të mbajtur njerëzit tanë të sigurt. Nëse Rusia mendon se do të përçahemi nga kërcënimi ose nëse mendon se do të dekurajohemi nga mbështetja e Ukrainës, gabohet. Uniteti ynë është i patundur”, theksoi Mark Rutte, sekretar i përgjithshëm i NATO-s.

Përballë përshkallëzimit të tensioneve, mesazhi i përbashkët nga Brukseli është se Evropa dhe NATO do të veprojnë të koordinuara. Krahas presionit ndaj Rusisë, Bashkimi Evropian po diskuton edhe rritjen e mbështetjes për Ukrainën, përfshirë forcimin e mbrojtjes ajrore. Takimi vjen në një moment kur incidenti i Leipzigut shihet si një tjetër provë për sigurinë evropiane dhe për aftësinë e vendeve anëtare për t’iu përgjigjur kërcënimeve hibride, ndërsa BE-ja dhe NATO përsërisin se mbështetja për Ukrainën nuk do të dobësohet.



Redaksia Web

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



BOTA

Tragjedi! Përmyset anija me pasagjerë,...

Xhuljana Zhuleku 5 orë më parë



BOTA

Zjarr masiv në Kroaci, evakuohen 230...

Xhuljana Zhuleku Dje 19:36



BOTA

Trump: Lufta me Iranin do të...

Xhuljana Zhuleku Dje 18:51



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale